



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



## Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 675117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

### V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji Iliria për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS, maksimumi 44 studentë për vit akademik.
- II. Akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji Iliria për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS, (me specializime: Biznes Ndërkombëtar; Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet) maksimumi 400 studentë për vit akademik.
- III. Akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji Iliria për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2019:
  - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS, (me specializime: Biznes Ndërkombëtar; Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment Shëndetësor), maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- IV. Obligohet Kolegji Iliria, që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzojë planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

- V. Obligohet Kolegji Iliria, që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Obligohet Kolegji Iliria të respektojë vendimin për fuzionimin e programeve të studimit në nivelin bachelor dhe master, të datës 22.02.2017. I ndalohej Kolegjit Iliria regjistrimi i studentëve të rinj në programet e fuzionuara si në vijim:
- Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA
  - Menaxhment dhe Informatikë, BA
  - Biznes Ndërkombëtarë, BA
  - Banka, Financa dhe Kontabilitet, MA
  - Menaxhment dhe Informatikë, MA
  - Biznes Ndërkombëtarë, MA
  - Menaxhment Shëndetësor, MA
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS; Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS; dhe Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	MA	120	Lisen Bashkurti, Ngadhnjim Brovina, dhe Hekuran Rapaj
2	Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi	BA	180	Mixhait Reçi, Miraç Hani, dhe Nasir Selimi
3	Biznes dhe Ekonomi	MA	120	Shpresa Reshidi, Nuredin Lutfiu, dhe Marsela Luarasi

AKA ka organizuar vizitën në Kolegji Iliria më 24.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Volker Gehmlich, dhe Reinhard Meyers.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji Iliria, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji Iliria ka dorëzuar shkresë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) më datë 22.02.2017 me anë të së cilës njofton AKA-në për fuzionimin e programeve të cekura në pikën VI të këtij vendimi, dhe se duke filluar nga viti akademik 2017-2018 Kolegji Iliria do të regjistrojë studentë të fushës së ekonomisë vetëm në programet e fuzionuara, përkatësisht programet e cekura në pikën II dhe III të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Iliria;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

